

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 192 Prot.

Tiranë, më 17.03.2015

VENDIM Nr. 20, datë 11.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi "Relacionin për verifikimin në terren të murit antik, të zbuluar gjatë zbatimit të punimeve, në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Historike"-Lezhë, realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

- I. Të realizohet nga ASHA, e mbështetur edhe nga Bashkia Lezhë, rilevimi dhe dokumentimi i murit antik, të zbuluar gjatë zbatimit të punimeve, në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Historike"-Lezhë.
- II. Pas përfundimit të dokumentimit, Bashkia e Lezhës të kryejë punimet për kthimin e terrenit në gjëndjen e mëparshme, me qëllim realizimin e lulishtes së parashikuar, në projektin "Rehabilitimi i Qendrës Historike"-Lezhë".
- III. Bashkia e Lezhës, të vendosë tabelat informuese, në të dyja pozicionet, ku janë zbuluar muret antikë, gjatë zbatimit të punimeve në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Historike"-Lezhë dhe nënprojektit "Rikualifikimi i lulishtes së Qendrës"-Lezhë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO